



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2013 për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendeve Komunale, më 05.10.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **BESART HAJREDINAJ** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrrisë, nga subjekti politik "AAK-LDD" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Rrahim Ajeti**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Vushtrri, që ky vendim t'i komunikohet **z.Besart Hajredinaj**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Vushtrri, të datës 03.10.2017, Nr.1867/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z. Rrahim Ajeti pas dorëheqjes së tij të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rënditur, i cili është z. Besart Hajredinaj nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 05.10.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka